

Gjyqtare Ina Rama

Znj. Rama, e lindur në Tiranë në vitin 1972, u diplomua “juriste” pas përfundimit të studimeve të larta në vitin 1995 në Fakultetin e Drejtësisë, Universiteti i Tiranës. Në vitet 1996-1999 kreu funksionet e ndihmësgjyqtares pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Durrës, detyrë të cilën e ndërpreu për të ndjekur studimet në Shkollën e Magjistraturës. Në vitin e tretë të stazhit profesional përgjatë studimeve në Shkollën e Magjistraturës, ushtroi funksionet e gjyqtares pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Durrës dhe, pas përfundimit të këtyre studimeve, u emërua gjyqtare në Gjykatën e Shkallës së Parë Lushnjë, detyrë të cilën e ushtroi gjatë viteve 2002-2005.

Nga janari i vitit 2005 deri në nëntor të vitit 2007, znj. Rama ushtroi funksionet e gjyqtares në Gjykatën e Apelit për Krime të Rënda, detyrë të cilën e ndërpreu së ushtruar për shkak të emërimit në nëntor të vitit 2007, si Prokurore e Përgjithshme e Republikës së Shqipërisë. Në këtë detyrë, qëndroi deri në përfundim të mandatit pesëvjeçar, në dhjetor të vitit 2012.

Nga viti 2014 deri në vitin 2017, znj. Rama ka punuar në sistemin bankar si këshilltare ligjore e CEO-s së Bankës Credins, detyrë të cilën e ndërpreu për shkak të emërimit të saj nga Kuvendi i Shqipërisë si gjyqtare pranë Kolegjit të Posaçëm të Apelit në qershor të vitit 2017, detyrë të cilën vazhdon ta mbajë aktualisht. Përgjatë këtyre viteve të angazhimit profesional, znj. Rama ka ushtruar edhe funksionet e gjyqtares në Kolegjin Zgjedhor, si edhe vazhdon të jetë e caktuar si gjyqtare *Ad Hoc* për shtetin shqiptar në Gjykatën Evropiane të Drejtave të Njeriut në Strasburg.

Znj. Rama është e angazhuar edhe në fushën akademike, si pedagoge e jashtme në Shkollën e Magjistraturës dhe në fakultetin e së Drejtës së Biznesit në Tirana Business University, si dhe në rolin e ekspertes në trajnimin vazhdues të kryer për gjyqtarë e prokurorë nga Shkolla e Magjistraturës, për një periudhë 10-vjeçare.